



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBER
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE DHE ADMINISTRATIMIT TË UJËRAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Projekt -Vendim
329/ 07/10
Nr..... Date.....2021

Per Zgjidhjen e konfliktit per furnizim me uje per ujitje te fshatrave Potgorc dhe Vojnik.

Mbeshtetur ne ligjin 139/2015 ‘Per Veteqeverisjen vendore’ ,neni 9 ,pika 1.1/b,neni 27,pika 1 ku citohet “bashkite jane pergjegjese per administrimin ,shfrytezimin dhe mirembajtjen e infrastruktures se ujitjes dhe kullimit te transferuara ne pronesi te tyre sipas menyres se percaktuar me ligj”, neni 54 pika dh dhe k, neni 64 .germa c. V.K.M Nr 1108,date 30.12.2015 , “Per transferimin nga Ministria e Bujqesise dhe zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave te Bashkite te Infrastruktures se ujitjes dhe kullimit te personelit dhe te asetëve te luajtshme dhe te paluajtshme te bordeve rajonale te kullimit”, Ligj 24/2017 neni 3 ,neni 4,neni 24, ligji 111/2012 neni 41. pika 1 germa b neni 45 pika d per zgjidhjen e konfliktit per furnizimin me uje te fshatrave Potgorc dhe Vojnik,

Keshilli Bashkiak Diber ne mbledhjen e dates 11 10 2021

Vendosi;

1-Uji per ujitje i Burimit uJOR (Peroi ndermjet allabegise dhe Vojnikes) te ndahet ndermjet paleve ne konflikt referuar siperfaqes se tokes nen uje ne pronesi ose perdorim , qe mbulon ky burim uJOR sipas grafikut te hartuar nga Njesia Administrative Maqellare e percaktuar me dite ose me ore brenda dites gjate sezonit te ujitjes ne vitin perkates.

Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit per bazueshmerine ligjore nga Prefekti i Qarkut Diber

Pergjegjes i sektorit Juridik


Elona Lusha

Drejtor i Bujqesise

Ramazan ZILI

KRYETARI I BASHKISE NE DETYRE

SHKELQIM MURRJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE DHE ADMINISTRATIMIT TË UJËRAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Nr. _____ Prot.

Peshkopi, më 7 / 10 / 2021

RELACION- TEKNIK

Per zgjidhjen e konfliktit per furnizim em uje per ujitje te fshatrave Potgorc dhe Vojnik

Lenda: Mbi konfliktin ndermjet Z.Allaman Beça dhe komunitetit te 2 (dy) fshatrave te Njesise Administrative Maqellare (Potgorc dhe Vojnike) lidhur me ujin e ujitjes.

Drejtuar: Keshillit Bashkiak te Bashkise Diber.

Referuar dokumentacionit te derguar nga Kryetari i Njesise Administrative Maqellare dhe te kryepleqve te fshatave Podgorce dhe Vojnike lidhur me problematiken e lindur si rezultat i ndarjes se njeaneshme te ujit nga z. Allaman Beça sqarojme si me poshte:

Z.Allaman Beça ka nderprere ujin ne kanalin ujites qe furnizon me uje dy fshatrat e Njesise Adminisrative Maqellare (Podgorc dhe Vojnik) .Nje veprim i tille ka çuar ne konflikt me fermeret e tjere qe realizojne ujitjen nepermjet ketij kanali ujites dhe qe kane edhe mbeshtetjen e dy kryepleqve te dy fshatrave ne kerkesen e tyre per furnizimin me uje per ujitjen e tokave te tyre

Ne vazhdim te negociatave te kryera nga kryepleqte e ketyre dy fshatrave me mbeshtetjen edhe te kryetarit te njesise Administrative Maqellare por pa aritur ne zgjidhje konkrete u organizua takimi ne ambjentet e Bashkise nen drejtimin e Sekretares se Pergjitheshme te Bashkise me pjesmarjen e drejtuesve te Administrates se Bashkise per kete sektor,dy kryepleqve te fshatrave (Gjuri Maksuti dhe Shaban Beça),perfaqesues i Njesise Ad.Maqellare Z.Gezim Kosiqi ne prezencen e Z.Allaman Beça.

Pas diskutimeve reth problemit per te gjetur nje zgjidhje te pranueshme Z.Allaman Beça nuk leviz nga pozicioni i tij duke pretenduar se kete uje do ta perdore ai me te afermit e tij dhe pjesa tjeter e dy fshatrave te beje ujitjen me rrjedhjet e mundeshme pas marjes se ujit prej tij.

Dy kryepleqte e fshatrave pretendojne se ky person nuk duhet te mare Uje ne vendin ku e ka marre ne fakt por ne nje vend tjeter. Pamvaresisht sa u tha dhe shkresave te derguara nga kryepleqte, u konstatua nje lloj terheqje per te gjetur nje zgjidhje jo konfliktuale por nuk pati mirekuptimin e z.Allaman. Ne keto kushte Uji vazhdon te mbahet nga Z.Allaman Beça duke vene ne veshtiresi serioze pjesen tjeter te fermereve te dy fshatrave.

Normalisht per probleme te kesaj natyre perparesi marin vendimet e pleqesive te fshatrave.

Marja e nje vendimi nga keshilli bashkiak eshte edhe kerkese e drejtorise se policise per nderhyrje per zgjidhjen e konfliktit.

Referuar problemit teper konfliktual kerkojme trajtimin e tij ne Keshillin Bashkiak ne nje afat sa me te shpejte te mundeshem.

Per propozimin e projekt-vendimit jemi bazuar ne vendimet e pleqesise se dy fshatrave te derguara ne Keshillin Bashkiak me relacion, si dhe ne legjislacionin qe ka te beje me administrimin e ujerave. Konkluzionet jane nxjerre duke ju referuar termit uje si prone shtetore pamvaresisht se per rastin konkret nuk kemi sistem ujitje ne inventar te transferuar prane Bashkise. Nuk jane marre parasysh pretendimet e asnjeres nga palet sic pretendojne ata ,por eshte propozuar nje forme zgjidhje e ndermjetme.

Ne referencat ligjore i jemi referuar procedures se ndjekur si per burimet e tjera ujore qe kane per baze ujin shtetor. Sipas referimeve te bazes ligjore ne proekt - vendim sqarojme si me poshte:

Ligjin **139/2015** neni 9 pika 1.1.b Per nxerrjen e projekt-vendimeve nga njesite e qeverisjes vendore. Neni 27 pika 1, ku Bashkite jane pergjegjese per administrimin e ujitjes. Neni 54 pika n ,Per vendosjen e procedurave per funksionet e deleguara pika k per miratimin e nismave dhe kritere per interes publik, neni 64 Per dergimin e materialeve nga Kryetari i Bashkise ne Keshill Bashkiak.

Vkm nr. **1108** date **30.12.2015** Per transferimin e infrastruktures se ujitjes

Ligji **24/2017** neni 3 dhe 4 per pronesine shtetore te burimeve dhe mbrojtjen e interesave te te gjitha perfituesve ,neni 24 per te drejta te barabarta per furnizim me uje .


Ligji **111/2012** Per menaxhimin e burimeve ujore ,neni 41 pika 1 germa b Per te drejten e perdorimit nga cdo fermer per ujitje, neni 45 pika d per mbrojtjen e interesave te perdoruesve te tjere te ujit ne te njejtin burim.

Faleminderit per bashkepunimin.

Konceptoi:

Pergj.Ad. te Ujrave Arben Dani

Specilisti sek.Ujrave Fatos Mandri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
Njësia Administrative Maqellarë

Kryesia e Fshatit Potgorcë ,Vojnikë

Maqellare me, 29/07/2021

Drejtuar:Këshillit Bashkiak Dibër.

ANKESË





Ne personat e poshtë shënuar po ju drejtohem i Juve për të na zgjidhur problemin tone për vadijen e tokave tona ,pasi Allaman Beça na ka ndërprerë ujin vadiës qysh në fillim të sezonit të vadijes të fshatit Potgorcë dhe Vojnikë.Kemi bërë disa here ankesa për këtë problem ,por nuk kemi mare zgjdhje.Prandaj ju drejtohem i Juve Këshillit Bashkiak Dibër për të na e zgjidhur këtë problem pasi i kemi pa vadiur akoma misrin.
Mbetemi me shpresë se kërkesa jonë do meret parasush.

Bashkëngjitur po ju sjellim listen e fermerëve të të dy fshatrave që vadisin token bujqësore me këtë vijë uji.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Drejtuar : KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR.


Lista e fermerëve të fshatit Potgorcë dhe Vojnikë që vadisin tokën bujqësore në vendin e quajtur Sllatina me vijën e përroit.

1.Vehbi Maksuti	6000 m ²		20.Shaban Beça	7500 m ²	
2.Latif Jani	3000 m ²		21.Mazlum Beça	7000m ²	
3.Hamet Dina	6000 m ²		22. Allaman Beça	5000 m ²	
4.Fehmi Beça	2500 m ²		23.Hasan Ceku	4000 m ²	
5.Rifan Dani	2000 m ²		24.Bujar Ceku	4000 m ²	
6.Fatos Dani	2000 m ²		25.Bardhyl Ceku	4000 m ²	
7.Petrir Dani	8000 m ²		26.Rustem Ceku	4000 m ²	
8.Kamber Beça	1500 m ²		27.Alfred Jolla	6500 m ²	
9.Skënder Beça	13000 m ²		28.Ramazan Alla	4500 m ²	
10.Elton Toçi	5000 m ²		29.Nexhat Beça	4000 m ²	
11.Fane Dani	12000 m ²		30.Tulman Beça	4000 m ²	
12.Lavdrim Beça	4000 m ²		31.Oltion Beça	4000 m ²	
13.Fatrie Huna	2000 m ²		32.Elvis Beça	4000 m ²	
14.Dervish Huna	2000 m ²		33.Bilal Maksuti	5000 m ²	
15.Zenulla Huna	2000 m ²		34.Gjuran Beça	2000 m ²	
16.Flamur jolla	3000 m ²		35.Ylli Beça	4000 m ²	
17.Sokol Jolla	3000 m ²		36.Avni Beça	4000 m ²	
18.Kadri Musa	1500 m ²		37.Fatos Osmani	7000 m ²	
19.Mazllum Beça	1500 m ²				


Shumë 162 Hq

Kryetari i Fshatit Potgorcë

Kryetari i Fshatit Vojnikë



Gjuri MAKSUTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE DHE ADMINISTRATIMIT TË UJËRAVE

SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Nr. 2557 Prot.

Peshkopi, më 27/07/2021

2557

RELACION

Lenda: Mbi konfliktin ndermjet Z.Allaman Beça dhe komunitetit te 2 (dy) fshatrave te Njesise Administrative Maqellare (Potgorc dhe Vojnike) lidhur me ujin e ujitjes.

Drejtuar: Keshillit Bashkiak te Bashkise Diber.

Referuar dokumentacionit te derguar nga Kryetari i Njesise Administrative Maqellare dhe te kryepleqve te fshatave Podgorce dhe Vojnike lidhur me problematiken e lindur si rezultat i ndarjes se njeaneshme te ujit nga z. Allaman Beça sqarojme si me poshte:

Z.Allaman Beça ka nderprere ujin ne kanalin ujites qe furnizon me uje dy fshatrat e Njesise Administrative Maqellare (Podgorc dhe Vojnik) .Nje veprim i tille ka çuar ne konflikt me fermeret e tjere qe realizojne ujitjen nepermjet ketij kanali ujites dhe qe kane edhe mbeshtetjen e dy kryepleqve te dy fshatrave ne kerkesen e tyre per furnizimin me uje per ujitjen e tokave te tyre

Ne vazhdim te negociatave te kryera nga kryepleqte e ketyre dy fshatrave me mbeshtetjen edhe te kryetarit te njesise Administrative Maqellare por pa aritur ne zgjidhje konkrete u organizua takimi ne ambjentet e Bashkise nen drejtimin e Sekretares se Pergjitheshme te Bashkise me pjesmarjen e drejtuesve te Administrates se Bashkise per kete sektor,dy kryepleqve te fshatrave (Gjuri Maksuti dhe Shaban Beça),perfaqesues i Njesise Ad.Maqellare Z.Gezim Kosiqi ne prezencen e Z.Allaman Beça.

Pas diskutimeve reth problemit per te gjetur nje zgjidhje te pranueshme Z.Allaman Beça nuk leviz nga pozicioni i tij duke pretenduar se kete uje do ta perdore ai me te afermit e tij dhe pjesa tjeter e dy fshatrave te beje ujitjen me rrjedhjet e mundeshme pas marjes se ujit prej tij.

Dy kryepleqte e fshatrave pretendojne se ky person nuk duhet te mare Uje ne vendin ku e ka marre ne fakt por ne nje vend tjeter. Pamvaresisht sa u tha dhe shkresave te derguara nga kryepleqte, u konstatua nje lloj terheqje per te gjetur nje zgjidhje jo konfliktuale por nuk pati mirekuptimin e z.Allaman. Ne keto kushte Uji vazhdon te mbahet nga Z.Allaman Beça duke vene ne veshtiresi serioze pjesen tjeter te fermereve te dy fshatrave.

Normalisht per probleme te kesaj natyre perparesi marin vendimet e pleqesive te fshatrave qe mund te citoheshin nga ana jone ne projrkt –vendim te regullt per miratim ne keshill. Por referuar faktit se probleme te tilla jane te shumta dhe mund te paraqiten ne vazhdimesi ne Keshillin Bashkiak po e paraqesim relacionin pa propozime konkrete per ti dhene mundesi diskutimit me te gjere ne Keshillin Bashkiak dhe ne aritjen e nje vendimi sa me te aresyeshem te mundeshem .

Marja e nje vendimi nga keshilli bashkiak eshte edhe kerkese e drejtorise se policise per nderhyrje per zgjidhjen e konfliktit.

Referuar problemit teper konfliktual kerkojme trajtimin e tij ne Keshillin Bashkiak ne nje afat sa me te shpejte te mundeshem.

Bashkengjitur po ju dergojme dokumentacionin e derguar prane Bashkise nga Njesia Administrative Maqellare dhe vendimet e pleqesive te dy fshtrove lidhur me kete problem dhe listat me nenshkrimet e personave te derguara nga kryepleqte si dhe listat me nenshkrimet e personave te derguara nga z.Allaman Beça.


Faleminderit per bashkepunimin.

Pergjegjes i Sektorit Juridik Drejtori Bujqesise **KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË**

Elona Lusha



Ramazan Zili



Shkëlqim MURRJA

Ne mungese dhe me porosi

Sekretar i pergjithshem





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 45 Datë 11.10.2021

Për Zgjidhjen e konfliktit për furnizim me ujë për ujitje të fshatrave Potgorc dhe Vojnik.


Në mbështetje të ligjit 139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen vendore’ ,neni 9 ,pika 1.1/b,neni 27,pika 1 ku citohet “Bashkitë janë përgjegjëse për administrimin ,shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit të transferuara në pronësi të tyre sipas mënyrës së përcaktuar me ligj’, neni 54 pika dh dhe k, neni 64 .gërma c. V.K.M Nr 1108,datë 30.12.2015 , “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të Bashkitë të Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, Ligj 24/2017 neni 3 ,neni 4,neni 24, ligji 111/2012 neni 41. pika 1 gërma b neni 45 pika d për zgjidhjen e konfliktit për furnizimin me ujë të fshatrave Potgorc dhe Vojnik, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 11.10.2021 miratoi me 16 vota pro 0 kunder 0 apstenim.


Vendosi :

1. Të miratojë projektin për ujitje të Burimit ujqor (Përoi ndërmjet allabegisë dhe Vojnikës) të ndahet ndërmjet palëve në konflikt referuar sipërfaqes së tokës nën ujë në pronësi ose përdorim , që mbulon ky burim ujqor sipas grafikut të hartuar nga Njësia Administrative Maqëllarë e përcaktuar me ditë ose me orë brënda ditës gjatë sezonit të ujitjes në vitin përkatës.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit për bazueshmerinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Dibër
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buqësisë, Pyjeve dhe administrimit të ujrave dhe Njësia Administrative Maqëllarë
4. U shpall sot me datë **11.10.2021**

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.975/1.prot.

Peshkopi, më 20.10.2021

Lënda : Per vendimin nr. 45, datë 11.10.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Diber nr.45, date 11.10.2021 “Për zgjidhjen e konfliktit për furnizimin me ujë për ujitje të fshatrave Potgorc dhe Vojnik”, konstatova se vendimi objekt verifikimi dhe shqyrtimi në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” bën pjesë në fushën e kompetencave të veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për rrjedhojë Prefekti miraton në parim një vendimmarrje të tillë që është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër .

